

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “KALUX” shpk

Sot në Tiranë më datë 29.10.2025, ne:

1. Z. Alfred Mezini, atësia Imran, amësia Mynevere, i datëlindjes 27.07.1968, lindur dhe banues në Tiranë në Rrugën “Themistokli Gërmenji, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. G80727108K.
dhe
2. Znj. Kaltra Mezini, atësia Alfred, amësia Brunilda, e datëlindjes 18.05.2003, lindur dhe banues në Tiranë në Rrugën “Themistokli Gërmenji, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. K35518034U.

Vendosëm të themelojmë e të nënshkruajmë këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “KALUX” shpk. Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga ky akt themelimi, statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 1 Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është “KALUX” shpk.

Neni 2 Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2.2 Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014) dhe këtë statut.

Neni 3 Selia

- 3.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rr. “Sabaudin Gabrani”, Nj. Administrative Nr. 6, godinë 2 katëshe, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria mund të shtrijë aktivitetin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Ajo mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.4 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë

Neni 4 Kohëzgjatja



4.1 Periudha e aktivitetit të shoqërisë është pa afat

NENI 5
Objekti i Shoqërisë

- 5.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanërisht si më poshtë:
- i. Shitje me shumice dhe pakice në dyqan dhe nepermjet faqeve të internetit të produkteve në fushën e mobilerisë si: Mobilje për shtëpi, mobilje zyresh, mobilje restorantesh, mobilje për hoteleri, aksesore dhe produkte për dekorime të ambienteve të brendshme dhe të jashtme;
 - ii. Marketing, demonstrim i mallrave, asistencë për menaxhim komercial apo industrial;
 - iii. Shërbime të agjencisë import-export, reklamimi / publiciteti;
 - iv. Marrëdhëniet me publikun, organizimi i ekspozitave për qëllime komerciale ose reklamuese, promovimi i shitjeve për të tjerët, organizimi i panairëve tregtarë për qëllime komerciale ose reklamimi; reklamimi në internet në një rrjet kompjuterik, shërbime prokurimi për të tjerët (blerja e mallrave dhe shërbimeve për biznese të tjera), prezantimi i mallrave në media komunikimi, për qëllime të shitjes me pakicë; informacion tregtar dhe këshilla për konsumatorët në zgjedhjen e produkteve dhe shërbimeve; shërbimet e paraqitjes për qëllime reklamimi; marrja me qira e stendave të shitjes; shërbime të ndërmjetësimit komercial, negocimi dhe përfundimi i transaksioneve tregtare për palët e treta;
 - v. Sigurimi i një tregu në internet për blerësit dhe shitësit e mallrave dhe shërbimeve, hartimi i materialeve reklamuese, promovimi i mallrave dhe shërbimeve përmes sponsorizimit të ngjarjeve sportive. Transporti për llogari të vet dhe të tretëve, që do të kryhet me mjetet e tyre dhe / ose palëve të treta, brenda dhe jashtë vendit;
 - vi. Mobilje; mobilje prej metali; mobilje zyre; ndarje mobiljesh prej druri / ndarje prej druri për mobilje; korniza fotografish; pasqyra; raftë mobiljesh; kolltuqe; tavolina; perde prej bambuje; vitrina [mobilje]; perde të brendshme dritareje prej druri të endur; stolë banjoje; mobilje banjoje [mobilje]; aksesore shtrati, jo prej metali; shtretër prej druri; stola [mobilje]; jastëkë; jastëkë cilindrikë; raftë për shishe; raftë për magazinim; këmbë për mobilje; dollapë me çelës [mobilje]; karrige; mentesha, jo prej metali; divanë; sofa; dyer; organizues sirtarësh; sirtarë për mobilje; mobile dekorative [zbukurime varëse]; ratan, i papërpunuar ose gjysmë i përpunuar; vida me kunjë, jo prej metali; statuja prej druri, dylli, allçie ose plastike; shufra druri; stola; mbajtëse çadrash; garderoba; vepra arti prej druri, dylli, allçie ose plastike.
- 5.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë që nuk bien ndesh me ligjet Shqiptare në fuqi.
- 5.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut.
- 5.4 Shoqëria mund të marrë të drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja .



KAPITULLI III
Kapitali Themeltar, Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 6
Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.000.000 (tre milion) lekë, do të depozitohet në llogari të shoqërisë, në një Bankë të nivelit të dytë, pas regjistrimit në QKB .

Neni 7
Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat

- 7.1 Ortakët themelues të Shoqërisë dhe kuotat e zotëruar prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:
- a) **ALFRED MEZINI**, zotëron **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) Lekë, që përfaqëson **60 (gjashtëdhjetë) %** të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - a) **KALTRA MEZINI**, zotëron **1 (një) kuotë** me vlerë nominale 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) Lekë, që përfaqëson **40 (dyzet) %** të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 8
Transferimi i kuotave ndërmjet ortakëve

Kuotat e kapitalit themeltar janë të transferueshme sipas parashikimeve të statutit.

Neni 9
Organet e shoqërisë

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:


- Administratorët
- Asambleja e Përgjithshme

Neni 10
Administratori

Administratori i shoqërisë është:

- **Znj. Ela Gjiknuri**, atësia Josif, amësia Lefko, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 29.10.1989, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, në adresën Rrgua Sami Frasheri, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. **Personal I96029065D**

Neni 11
Kompetencat e Administratorit



Page 3 of 4

Kompetencat e administratorit janë sipas statutit të shoqërisë dhe ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ” (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014).

Neni 12


Fuqia e akteve

Të gjitha çështjet për të cilat ky akt themelimi nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ” (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014), të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ky akt themelimi është bërë në 2 kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

ALFRED MEZINI

Alfred Mezini


KALTRA MEZINI

Kaltra Mezini
